



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI DREJTUES

Nr. 288 / prot
12

Tiranë më 26 / 11 / 2024

**PROCESVERBAL
MBLEDHJE BORDI**

(Datë, 26/11/2024)

Të pranishëm nga Bordi Drejtues: Znj.Jonila Godole, Znj.Enriketa Pandelejmoni, Z.Vasil Tole, Z. Alfred Lako, G.Peshkëpia.

Të pranishëm nga Instituti : Z.Çelo Hoxha
Znj.Zoica Graçi

Hapet mbledhja

J.Godole: Përshëndetje, e hapim mbledhjen. Na janë dërguar materialet e mbledhjes dhe sot do të diskutojmë disa çështje si: zgjedhja e drejtorit të ri, komunikimi me Kuvendin për zgjedhjen e bordit të ri, mandati i bordit ekzistues, gjendja e zyrave, informim për projekt-buxhetin 2025 etj. Fillojmë me diskutimin për çështjen e parë.

Ç.Hoxha: Për çështjen e parë, pas komunikimit me Bordin për shkak të gjendjes juridike në të cilën ju jeni, i jam drejtuar Kuvendit me shkresë për situatën. Presim përgjigje zyrtare për shkresën e dërguar. Në rrugë jo zyrtare, burime nga Kuvendi në takime që kam patur për çështje të tjera më është thënë se Bordi mund të vazhdojë punën normalisht deri në zgjedhjen e Bordit të ri.

Për çështjen e dytë mund të diskutojmë, por nuk ka zhvillime. Bordi i ri mendojnë se do të vonojë. Kuvendi nuk parashikon që Bordi i ri të zgjidhet këtë vit. Janë shprehur se institucionet të cilat duhet të dërgojnë kandidatuarat ashtu si e parashikon ligji nuk kanë çuar numrin e plotë për kandidatë. Instituti i ish të përdjekurve duhet të dorzojë nëntë kandidatura ku prej tyre, Kuvendi zgjedh tre. Edhe nga institucionet e tjera nuk janë plotësuar. Mendoj se është një mungesë vëmendje ndaj nesh mos zgjedhja akoma e Bordit, pasi është tejkalluar çdo afat.

Për zyrat po ju informojmë se ne nuk do të kthehemi më te zyrat. Ministria e Kulturës i ka shkruar Kuvendit dhe Kryeministrit ku i kërkon që të dy institutet mos të kthehen më anë ato zyra dhe ne nuk na kanë vënë në dijeni. Ne juridikisht nëse qeveria nuk do të na kthejë në ato zyra, nuk kthehemi por janë të detyruar të na gjejnë ambiente të tjera. Në zyrë ka ardhur një këshilltar i Ministrit të Ekonomisë dhe Kulturës ku na ka komunikuar se nuk do të kthehemi në ato zyra, dhe ministria po kërkon për të na sitemuar në zyra të tjera. Unë i kërkoja që këto informacione të dërgohen me shkresë nga ana e Ministrit, dhe pas kësaj ti drejtohem qeverisë dhe Kuvendit për gjetjen e zyrave të reja.

A.Lako: Këto zyra kush mendohet se do ti marri?

Ç.Hoxha: Mendojnë ti kthejnë në muze por këto janë informacione informale.

E.Pandelejmoni: Për këto informacione që keni për zyrat na informoni ne si Bord të përgatisim shkresa dhe tju drejtohem institucioneve përkatëse si: Kuvendit e Ministrisë. Përderisa rikonstruksioni i godinës ka përfunduar nuk kemi çfarë të presim për tu marrë në dorzim. Pjesa se ka vend apo nuk ka vend aty, ai është një objekt që shpreh një simbolikë të caktuar. Unë them që sa më shpejt të bëjmë shkresën zyrtare se çfarë po bëhet me godinën, pse nuk po i kthehet institutit akoma.

Ç.Hoxha: Po ne e kemi një shkresë gati pasi e kemi përgatitur këto ditë për tja dërguar institucioneve për ti treguar situatën. E dikutojmë këtu dhe e dërgojmë.

J.Godole: Unë mendoj që përveç shkresës kjo çështje të bëhet publike me gazetarë, pasi në këtë situatë që është instituti nuk kemi asgjë për të humbur. Kështu do të marri më shumë vëmendje.

V.Tole: Unë mendoj se nuk duhet të hiqni dorë nga godina. Jam për qasjen që ISKK si institucion i ngritur me ligj ka nevojë për një godinë që ka histori, dhe jo thjesht zyra. Prandaj godina aktuale i plotëson kushtet për të qënë edhe emblemë përfaqësimi edhe ambiente pune.

Letra duhet dërguar dhe duhet theksuar që godina është godina e ISKK.

G.Peshkëpia: Edhe unë jam dakort që duhet dërguar letër dhe të ktheni në zyrat përderisa ato kanë mbaruar me restaurimin.

J.Godole: Kjo ka qënë godina e parë e ish të përndjekutve ndaj mendoj se duhet të behen përpjekjet maksimale për të.

Ç.Hoxha: Javën që kaloi kishim nga Ministria e Kulturës një kontrat për një aktivitet që do të zhvillohej te zyrat e institutit. Unë e firmosa se në atë kontrat ata kanë përdorur ligjin e trashgimisë kulturore. Dhe e kërkojnë këtë si detyrim ligjor, nga ligji i monumenteve, i cili na detyron të hapim mjediset për publikun, etj.

J.Godole: Unë mora një ftesë nga organizatorët dhe shof që janë disa shoqata.

V.Tole: Sa për çështjen e hapjes së godinës për aktivitete padyshim që jam dakort.

E.Pandelejmoni: Për rikthimin në zyra duhet të bëhen disa përpjekje me shkresa dhe mediatike. Që të na anashkalojnë nuk është normale. Jemi institucion i krijuar me ligj dhe të zgjedhur nga Kuvendi. Ne duhet të dukemi në këto probleme. Takimi me Kuvendin dhe me Komisionin e Edukimit nëse është e nevojshme.

J.Godole: Duhet të vazhdojmë me kërkesën për takim me këto institucione. Të përdoren të gjitha shkresat që keni dërguar në shkresën që do të dërgoni për takim. Na e sillni një draft dhe e dërgojmë nga java.

Ç.Hoxha: Marrdhënia jonë është juridike. Çështja është që nëse nuk na kthejnë aty , duhet të na sistemojnë diku tjetër.

E.Pandelejmoni: Për çdo korespondencë me institucione të tjera ne duhet të jemi në kontakt.

A.Lako: Edhe unë jam dakort ti dërgohet shkresë Kuvendit për çështjen e zyrave.

J.Godole: Kemi çështjen e buxhetit për diskutim.

Ç.Hoxha: Për çështjen e buxhetit dua të them vetëm që sivjet kemi pasur një kërkesë specifike: zhvillimi i një aktiviteti ndërkombëtar, ku të ftojme gjithë anëtarët e Platformës Evropaine të Kujtesës dhe Ndërgjegjes, anëtarë të së cilës jemi. Kjo kërkon rreth 40.000 euro shpenzime. Të tjerat janë brenda kufijve të përvitshëm, në raport dhe me burimet njerëzore që kemi në dispozicion.

Për të dhënë shpjegime për buxhetin është e pranishme në mbledhje Drejtoresha e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

J.Godole: Është e rëndësishme për ndërkombëtarizimin e ISKK-së.

Z.Graçi: Kemi bërë kërkesat për këto shpenzime, por nuk e dim nëse do të miratohet. Kjo është një kërkesë prioritare shtesë.

J.Godole: Po në rregull. Për këtë kërkesë mendoj se duhet të keni edhe një shkresë partneriteti me platformen.

Ju falenderoj për pjesmarrjen dhe mbledhjen e mbyllim.

Jonila Godole Zv. Kryetar.....

Vasil Tole Anëtar

Enriketa Pandelejmoni Anëtar.....

Gëzim Peshkëpia Anëtar.....

Alfred Lako Anëtar.....

Mbajti procesverbalin

Liljana Aliko